

**Dr. Fehmi Pushkoll**

## **ORGANIZATAT POLITIKO-SHOQËRORE NË MITROVICËN E TITOS ME RRETHINË (1945—1947)**

Pas çlirimit të Mitrovicës së Titos me rrethinë, më 22 nëntor 1944, para të gjitha subjekteve të organizuara popullore u shtruan detyra të shumta, kryerja e të cilave kërkonte mobilizim të gjithmbarshëm, si për çlirimin e viseve të tjera të vendit nga pushtuesit fashistë, ashtu edhe për stabilizimin politik të gjendjes. Stabilizimi politik përmbante në vete luftën kundër forcave reaksionare, luftën për formimin e organeve të pushtetit popullor, të ndihmoheshin UNÇJ dhe AP të Kosovës dhe të Jugosllavisë, të formoheshin, të forcoheshin dhe të masivizoheshin organizatat politiko-shoqërore antifashiste dhe të punohej me të gjitha forcat për rindërtimin e rrethit të Mitrovicës së Titos, të Kosovës dhe të tërë vendit. Orientimi mbi këto baza krijoi mundësi që frytet e Luftës Nacionalçlirimtare dhe të Revolucionit Socialist të popujve të Kosovës të kurorëzoheshin me sukses. Për kryerjen e detyrave të shtruara rol vendimtar luajti organizata e PKJ-së për Kosovë dhe Metohi edhe në rrethin e Mitrovicës së Titos.

### **a. Partia Komuniste e Jugosllavisë për Kosovë dhe Metohi në rrethin e Mitrovicës së Titos**

Partia Komuniste e Jugosllavisë për Kosovë dhe Metohi, si në tërë vendin, edhe në rrethin e Mitrovicës së Titos ishte organizatë monolite, me disiplinë të fortë, e lidhur me masën dhe në pikëpamje ideore dhe politike unike. Në pikëpamje organizative ishte forcuar, po me çlirimin e rrethit u krijuan kushte që të forcohej edhe më shumë, të shtohej me pranimin e anëtarëve të rinj, sidomos nga radhët e anëtarëve të BRKJ-së të këshillave nacionalçlirimtare, FAG-ut, luftëtarëve të UNÇJ dhe të aradhave partizane dhe nga radhët e kandidatëve për anëtarë të Partisë. Kështu për gatitej baza që Partia të bëhej organizatë masive, por e ruajti karakterin e organizatës kadrovike gjatë tërë periudhës së rindërtimit, si në tërë vendin, edhe në rrethin e Mitrovicës së Titos. Pranimi i anëtarëve të rinj në PKJ ishte kërkesë që e shtroi KQ i PKJ-së, Komiteti Krahinor i PKJ-së për Kosovë dhe Metohi,<sup>1</sup> ngase i ne-

<sup>1</sup> AIHK, K-11, dok. nr. 1580.

vojiteshin kuadro për të udhëhequr organet e pushtetit popullor, ekonominë administratën, punët në organizatat antifashiste masive dhe për plotësimin e nevojave të tjera rreth rindërtimit të vendit.

Komiteti i rrethit i PKJ-së në Mitrovicën e Titos kërkesat e shtruara për shtimin e anëtarëve të Partisë nga organet e veta më të larta i zbatoi me konsekuencë. Organizata e Partisë kërkonte nga anëtarët e vet që ta ruanin idenë luftarake dhe orientimin për LNÇ dhe transformimin revolucionar të shoqërisë, duke i shtuar edhe gatishmërinë për zbatimin praktik të kriterëve të përcaktuara. Kjo shihej jo vetëm nga mënyra e pranimi të anëtarëve, por edhe nga tërësia e veprimtarisë së organizatës, baza programore, ideologjia dhe nga qëllimi si në nivel të rrethit, ashtu edhe më gjerë. Komiteti i rrethit i PKJ-së në Mitrovicën e Titos në fund të nëntorit të vitit 1944 u shtroi si detyrë të gjithë anëtarëve të vet që të punonin për edukimin dhe riedukimin e punëtorëve, fshatarëve, intelektualëve popullorë, rinisë dhe grave për punë dhe jetë demokratike, proces ky që kishte filluar gjatë Luftës Nacionalçlirimtare, por që duhej të vazhdohej, të zhvillohej dhe të thellohej edhe më shumë në të ardhmen. Detyrë e rëndësishme para anëtarëve të Partisë shtrohej edhe koordinimi i punës me këshillat nacionalçlirimtare dhe Komandën e vendit të UNÇ dhe të AP të Jugosllavisë në Mitrovicën e Titos<sup>2</sup> për stabilizimin e gjendjes politike. Organizata e Partisë në këtë rreth punonte në kushte të vështira. Për shkak të zhvillimit të operacioneve luftarake për çlirimin e këtij rrethi, populli kishte ikur nga fshatrat në verilindje të qytetit dhe kudo vërehej lëvizja e përgjithshme. Ndihej nevojë e furnizimit me ushqim dhe lëndë djegëse sidomos në qytet, për nevojat e punëtorëve të Xeherores „Trepça” dhe për UNÇ dhe AP të Jugosllavisë. Prandaj lypsej angazhim i përhershëm i komunistëve që populli të kthehej nëpër fshatrat e veta dhe të ndihmonte stabilizimin e gjendjes politike dhe ekonomike. Me qëllim që të kuptohej sa më mirë gjendja e krijuar, u bënë mitingje popullorë, konferenca, mbledhje e u aplikuan forma të tjera pune, ku masës i shpjegohej qëllimi i Luftës Nacionalçlirimtare, fitoret e arritura dhe nevoja e vazhdimi të luftës deri në çlirimin e tërë vendit, nevoja për të hyrë në radhët e UNÇJ, për ndihmën që duhej t’u jepte ajo njësiteve të armatosura në vendin e tyre, këshillave nacionalçlirimtare si organe të vetme të pushtetit të ri popullor dhe kërkohesh angazhimi i saj për rindërtimin e vendit të shkatërruar gjatë luftës kundër pushtuesve fashistë dhe bashkëpunëtorëve të tyre. Njëherësh, popullit i bëhej me dije dhe thirrej që me vendosmëri të luftonte kundër tradhtarëve të vendit, të cilët fshiheshin nëpër male nga frika se do t’i paguanin krimet që i bënë kundër popullit dhe atdheut si bashkëpunëtorë të pushtuesit gjerman. Në terrenin e rrethit të Mitrovicës së Titos vepronin forca të fuqishme kundërrevolucionare, si nga radhët e

---

<sup>2</sup> *Mitrovica me rrethina*, Mitrovicë 1979, 422.

shqiptarëve, si nga radhët e serbëve,<sup>3</sup> kundër të cilave luftuan jo vetëm njësitet ushtarake, por edhe populli.

Komiteti i rrethit i PKJ-së në Mitrovicën e Titos në fillim të dhjetorit të vitit 1944 organizoi këshillimin me aktivistët e Partisë, ku morën pjesë rreth 40 delegatë, ndër të cilët edhe Ali Shukriu, delegat i Komitetit Krahinor të PKJ-së për Kosovë dhe Metohi. Referatin mbi situatën politike e paraqiti Milija Kovaceviçi, ku u paraqitën edhe referate të tjera<sup>4</sup> dhe u zhvillua një diskutim i gjërë. Në referatin mbi situatën politike u trajtuan problemet e politikës së jashtme, sidomos marrëdhëniet ndërmjet aleatëve dhe situata politike në vend, me theks të veçantë në Krahinën e Kosovës dhe në rrethin e Mitrovicës së Titos. U tha se marrëdhëniet me shtetet fqinje janë të mira përveç me Greqinë, e cila ushtron terror mbi maqedonët në Greqinë Veriore, dhe me Italinë, e cila mban territorin ku jetojnë sllovenët dhe kroatët. Për situatën politike në Kosovë u theksua se armiku ishte thyer në luftën frontale, por bënte përpjekje që të organizohej dhe të sulmonte edhe qytetet e çliruara të Krahinës, prandaj nevojitej që komunistët edhe më tutje ta mobilizonin masën për luftë kundër forcave kundërrivolucionare. Në diskutim u shtrua çështja e Konfederatës Ballkanike, e reformës agrare, e unitetit të masës dhe e luftës kundër shovinizmit. Pas diskutimit, u shtruan këto detyra: të punohej në ngritjen e potencialit luftarak dhe të kryhej mobilizimi në rreth; të punohej më shumë për formimin e Frontit të Përbashkët Nacionalçlirimtar dhe aty të bashkoheshin shqiptarët, serbët dhe malazezët; që forca e Partisë të përqëndrohej në forcimin e pushtetit popullor; të popullarizohej udhëheqja e Luftës Nacionalçlirimtare dhe aleatët; të ngriteshin anëtarët e rinj dhe të intensifikoheshin puna ideopolitike.<sup>5</sup> Lidhur me punën e organizatave të Partisë u shpjegua se duhej të ndryshonte metoda e punës ngase kishin ndryshuar edhe kushtet. Komunistët gjatë LNÇ-së punonin në kushte ilegale, kurse pas çlirimit ata duhej të ishin organizatorë dhe bartës të tërë aktivitetit dhe t'i prinin masës në të gjitha aksionet. Në këshillim u theksua edhe udhëzimi i Komitetit Krahinor të PKJ-së për Kosovë dhe Metohi që në Parti të pranohen sa më shumë shqiptarë dhe të zbuten kriteret për pranimin e anëtarëve të rinj nga radhët e shqiptarëve. Kërkohej që komunistët gjatë punës t'i ruanin parimet e drejtësisë dhe të punonin me masën dhe ta përvetësonin atë për vijën e Partisë. Në këshillim u trajtua edhe puna e BRKJ-së dhe e BURAJ-it në rreth dhe u vlerësua se numri i anëtarëve të BRKJ-së në krahasim me luftën dhe punën e të rinjve ishte i vogël dhe sygjeroheshin që të pranoheshin anëtarë të rinj dhe të angazhoheshin më shumë në organizatat e BURAJ-të, në forcimin organizativ dhe në ngritjen ideopolitike të tyre. Puna e organizatës së FAG-ut në rreth u vlerë-

<sup>3</sup> *Aty*. 424—425.

<sup>4</sup> Si referati mbi punën e organizatës së Partisë, referati mbi këshillat Nacionalçlirimtar, referati mbi punën e Komandës së vendit, referati mbi punën e FAG-ut dhe referati mbi punën e BRKJ-së. AIHK, dokumenti i pa regjistruar.

<sup>5</sup> *Po aty*.

sua si e mirë, por kishte disa dobësi, të cilat duhej t'i mënjanonte Konferenca e FAG-ut për rrethin e Mitrovicës së Titos, të zgjedhjeve udhëheqja, të punohej në ngritjen ideopolitike të grave, të organizoheshin femrat shqiptare dhe nga radhët e grave të pranoheshin anëtarë të PKJ-së. Në referatin mbi punën e këshillave nacionalçlirimtare u konstatua se ende kishte fshatra ku nuk ishin formuar dhe u mor qëndrim që të formoheshin sa më parë. Në Mitrovicën e Titos vepronte këshilli nacionalçlirimtar i rrethit dhe i qytetit dhe pranë tyre ishin formuar edhe disa seksione, por nevojitej që të forcoheshin edhe më shumë. Njëherësh u kritikuan disa qëndrime burokratike të disa anëtarëve të këshillave nacionalçlirimtare. Para këshillave nacionalçlirimtare u shtruan shumë detyra, por më parësore ishte ndihma dhe bashkëpunimi me Komandën e Vendit, të UNÇ dhe të AP të Jugosllavisë. U vlerësua se Komanda e vendit, për kundër kushteve të vështira, arriti të forcohej edhe ta kryente funksionin e vet.

Komiteti i rrethit i PKJ-së në Mitrovicën e Titos gjatë dhjetorit të vitit 1944 u angazhua kryesisht për zbatimin në jetë të qëndrimeve të miratuara në këshillim. Njëherësh me aksione të përqëndruara punoi për zgjidhjen e problemeve të ndryshme që u paraqitën në këtë fazë të revolucionit. Organizatat e Partisë në këtë kohë u angazhuan dhe ndihmuan mobilizimin e popullit për luftë dhe për formimin e njësiteve të reja të UNÇ të Jugosllavisë duke dhënë kështu kontribut të çmueshëm për stabilizimin e gjendjes jo vetëm në rrethin e vet, por edhe në Kosovë dhe në Jugosllavi si tërësi. Gjatë janarit të vitit 1945 u bë edhe Këshillimi i Dytë i Organizatës së PKJ-së për rrethin e Mitrovicës së Titos, ku u analizuan rezultatet e arritura dhe u shtruan detyra të reja. Në Këshillim u vlerësua se forcat kundërrevolucionare aq e pengonin stabilizimin e gjendjes politike në rreth dhe në Krahinë, prandaj kërkoheshin angazhim edhe më i madh për shpartallimin e tyre dhe se në ballë të këtij aksioni duhej të viheshin komunistët. Detyrë e rëndësishme ishte organizimi i prodhimit në tërësi dhe në mënyrë të veçantë në Xehororen „Trepça”, e cila kishte rëndësi të madhe për plotësimin e kërkesave të nevojave të UNÇ të Jugosllavisë. Komiteti i rrethit i PKJ-së, Këshilli Nacionalçlirimtar i Mitrovicës së Titos dhe njësitet e UNÇ dhe të AP të Jugosllavisë rreth vazhimit dhe organizimit të prodhimit në „Trepçë” vepruan sipas „Qarkores për punë në ndërmarrjet e xehetarisë”<sup>6</sup> dhe me punën e tyre dhanë kontribut të rëndësishëm për stabilizimin ekonomik që nga ditët e para të çlirimit të këtij rrethi. Puna në xehorore, në industri dhe në ndërmarrje të tjera në rrethin e Mitrovicës së Titos ishte kontribut i organizatës së Partisë. Në shkurt të vitit 1945 në Kosovë, me Urdhëresën e Shtabit të Përgjithshëm të UNÇ dhe të AP të Jugosllavisë u vendos Qeverisja Ushtarake me qëllim që sa më parë të shpartalloheshin forcat kundërrevolucionare, të cilat synonin që në pranverë të vitit 1945 të organizonin kryengri-

<sup>6</sup> AIHK, dokumenti: „Nacionalni komitet oslobodjenja Jugoslavije”, Povremništvo za šume i rude, br. 275/44, 30 nëntor 1944 Beograd, Okružnica za rad po rudarskim preduzećima. Kjo Qarkore i dërgohej Këshillit Nacionalçlirimtar të Kosovës dhe Metohisë, i cili pastaj e përcolli nëpër rrethe.

tje të përgjithshme popullore në tërë Krahinën e Kosovës. Qeverisja Ushtarake në Kosovë veproi deri në gjysmën e vitit 1945. Mirëpo, me vendosjen e Qeverisjes Ushtarake nuk u ndërpre puna e organizatave politiko-shoqërore, përkundrazi ato ndihmuan me punën e tyre stabilizimin e forcimin e organeve të pushtetit popullor.

Konferenca e PKJ-së e rrethit të Mitrovicës së Titos u bë më 8 dhe 9 mars të vitit 1945 në Mitrovicën e Titos. Në Konferencë morën pjesë 36 delegatë nga rrethi i Mitrovicës së Titos dhe rrethi i Drenicës dhe anëtarët e Komitetit të PKJ-së për Rrethin e Mitrovicës së Titos. Në punën e Konferencës mori pjesë edhe Milladin Popoviq, sekretar i Komitetit Krahinor të PKJ-së për Kosovë dhe Metohi. Konferencën e shpalli të hapur Milija Kovaçeviq, sekretar i Komitetit të PKJ-së për rrethin e Mitrovicës së Titos dhe pas miratimit të rendit të ditës<sup>7</sup> punën e Konferencës e përshëndeti Milladin Popoviqi, i cili vuri në pah se Konferenca e Parë e PKJ-së e rrethit të Mitrovicës së Titos bëhej në kohën kur në vendin tonë shënohej kthesë e rëndësishme, prandaj Komiteti Krahinor i PKJ-së për Kosovë dhe Metohi vendosi që t'i bënte konferencat e Partisë në rrethe, të cilat do të ndihmonin që Konferenca Krahinore të shtronte sa më drejt detyrat për punën e mëtejme. Pastaj foli për Konferencën e Krimes dhe përpjekjet e reaksionit me mbretin në krye për të penguar stabilizimin e gjendjes në vend. Milija Kovaçeviq në referatin mbi situatën politike trajtoi gjendjen në rreth dhe vuri në pah se reaksioni bënte përpjekje që në formën e re të luftës të gjente aleat të ri duke e shfrytëzuar shovinizmin, vetëdijen e ulët politike të serbëve dhe të shqiptarëve dhe jo informimin e tyre. Se reaksioni kishte shfrytëzuar me mjeshtri dobësitë në punë dhe me këtë rrezikoheshin fitoret. Populli shqiptar në qytet kishte më shumë besim në pushtet, ushtri dhe në LNÇ-në sesa nëpër fshatra. Në disa fshatra shqiptarët frikësoheshin, kurse tek serbët në disa fshatra ndikimi i çetnikëve ishte i fortë. Për stabilizimin e situatës politike u theksuan këto detyra:

1. Me të gjitha forcat të punohej për ta larguar popullin nga ndikimi i reaksionit. Të komprometoheshin tradhtarët serbë dhe shqiptarë, të zbulohesh bashkëpunimi dhe planet e tyre tradhtarë. Të forcohej Fronti i Përbashkët Nacionalçlirimtar dhe të popullarizohej Komiteti i Shqiptarëve. Të ndihmohej populli që të kritikonte dhe të kërkonte përgjegjësi nga pushteti i vet. Të vërtetohesh pandërprerë nevoja e unitetit të popullit (shqiptar dhe serb) në luftë kundër fashizmit.

2. Me pa luhatje të punohej dhe të bindet populli që të jepet çdo gjë të mundshme në mënyrë që lufta të përfundonte sa më shpejt dhe të çlirohej vendi. Të shpjegohej se ai që ka ushtri të mirë dhe të fortë ka mundësi të ndihet i sigurt. Të gjithë të aftit,

<sup>7</sup> 1. Referati mbi situatën politike, 2. Referati mbi çështjet organizative, 3. Zgjedhja e Komitetit të ri të rrethit dhe 4. Të ndryshme. AIHK, Fondi OKKM, Sig. 431, nr. i dok. 2220.

shqiptarë dhe serbë, duhej të shkonin në ushtri dhe ushtria të furnizohej me ushqim. Se ushtria ishte fryti më i çmuar i luftës sonë.

3. Se duhej ti kushtohej tërë kujdesi ekonomisë në rreth. Me sukses të kryhej plani i mbjelljes, të ndihmohej tregtia për sigurimin e mallit dhe të fillonin punën ndërmarrja e tjegullave dhe sharra. Të organizojmë ato që i nevojiten popullit dhe atëherë edhe na i nevojitemi atij.

4. Anëtarët e Partisë ta përvetësonin vijën e Partisë sonë, të mësonin të jetonin me jetën e Partisë. Puna e anëtarëve të Partisë të vlerësohej sipas punës së kryer. Të lexohej shtypi. Që anëtarët e Partisë të dinin në çdo çast të shpjegonin ç'është uniteti i popujve të Jugosllavisë, ç'është Jugosllavia Federative Demokratike. Anëtarët e Partisë duhej të dinin të punonin në të gjitha seksionet: FPN, KNÇ, FAG, rinisë dhe të sindikatave.<sup>8</sup>

Organizatat e Partisë kishin punuar edhe për formimin dhe forcimin e organizatave politike masive. Ishte formuar Fronti i Përbashkët Nacionalçlirimtar i qytetit, ishte përgatitur baza për formimin FPN-së edhe nëpër komuna dhe ishte formuar Këshilli Iniciativ i FPN-së për rrethin e Mitrovicës së Titos. Milladin Popoviçi reziroi diskutimin rreth situatës politike dhe theksoi dy detyra: 1. Me të gjitha forcat të luftohet për fitore mbi okupatorin fashist dhe bashkëpunëtorët e tij dhe 2. të mobilizohen të gjitha forcat për rindërtimin e vendit.<sup>9</sup> Njëherësh vuri në pah se Partia duhej të angazhohej për përvetësimin e masave. Rrethanat në Krahinë diktuan nevojën që të gjendej forma për formimin e një organizate, nëpërmjet të cilës masa shqiptare do të lidhej më shumë me lëvizjen dhe Komiteti Krahinor me ndihmën e KQ të PKJ-së kishte vendosur të formohej Komiteti i Shqiptarëve, të cilit i shtrohej detyrë që ta studionte çështjen kombëtare të shqiptarëve, të punonte në kuadër të Frontit të Unjësuar Nacionalçlirimtar për t'i larguar shqiptarët nga ndikimi i reaksionit. Popoviçi ua bëri me dije delegatëve se Komiteti Qendror u kishte sygjeruar që nëpër fshatra të formoheshin Komitete, nga fshatarët e varfur, që do ta ndanin pasurinë e konfiskuar. Kjo kishte rëndësi politike, ngase do të përvetësoheshin fshatarët e varfur që të luftonin për vijën e Partisë. Referatin mbi çështjet organizative e paraqiti Milan Kërtolica, i cili vuri në pah se Komiteti i Rrethit i PKJ-së u detyrua të luftonte edhe kundër disa anëtarëve të Partisë, që ishin armiq. Këto masa ndikuan që Organizata e Partisë të vihej mbi baza të shëndosha dhe të trefishohej numri i anëtarëve, por komunistët e angazhuar me punë në disa sektore si në KNÇ, FUNÇ, BRKJ e të tjera nuk dëshmuan gjendshmëri dhe aftësi politike dhe organizative në tërësi, sidomos në organizatat nëpër fshatra. Pastaj anëtarët e Partisë nuk i kushtuan kujdesin e duhur punës me gra, e si rrjedhim i kësaj një numër i tyre ende nuk ishin lidhur me lëvizje. Nga ana tjetër, nuk ishte kuptuar rëndësia e formimit të FUNÇ- i për përvetësimin e masës që të vihej në vijën e

<sup>8</sup> AIHK, Fondi OKKM, Sig. 473, nr. i dok. 2272.

<sup>9</sup> Si shën. 7.

Partisë dhe të zhdukej ndikimi i armikut në masa.<sup>10</sup> Në diskutim u shpjegua forma e organizimit të FUNÇ-it, roli i komunistëve për aktivizimin e Frontit me qëllim që ai të bëhej parti politike udhëheqëse. Detyra parësore: u caktuan masivizimi i Partisë, depërtimi në masën shqiptare, forcimi organizativ dhe politik. Konferenca zgjodhi Komitetin e ri të rrethit prej 6 anëtarëve, sekretar Milija Kovaçevićin dhe 10 delegatë për Konferencën Krahinore të PKJ-së për Kosovë dhe Metohi.<sup>11</sup> Delegatët dhe Komiteti i ri i Partisë në Konferencë morën detyra, për zbatimin e të cilave duhej të angazhoheshin në terren dhe t'i zbatonin në jetë.

Organizata e Partisë në rrethin e Mitrovicës së Titos gjatë 4 muajve të parë të vitit 1945 me punën e vet arriti suksese të mëdha. Në Komitetin e Partisë të rrethit të Mitrovicës së Titos, më 27 prill 1945 u konstatua se nga ky rreth kishin mobilizuar për ushtri 2.795 veta, se kishin dezertuar 31 veta, se nga ky rreth nuk u ishin dorëzuar organeve të pushtetit edhe 46 të arratisur, se ishin bërë 520 konferenca dhe mitingje, se rekuizicioni ishte mbledhur pa dhunë dhe në fshatrat shqiptare më lehtë se në fshatrat serbe, sidomos në Luginën e Ibrit, ku ndikimi i çetnikëve ndihej edhe në disa familje të pasura në qytet, se ndihma për ushtri ishte mbledhur me sukses dhe ishin dalluar punëtorët, se puna vullnetare ishte e vogël, por u dalluan rinia dhe punëtorët, se ishin pranuar (janar-prill 1945) 105 anëtarë të Partisë dhe se kishin gjithsej 177 anëtarë,<sup>12</sup> se në BRKJ punonin 25 anëtarë të Partisë me 405 anëtarë të BRKJ-së, se kishin 8 kandidatë të Partisë, se në KNÇ punonin 27 anëtarë të Partisë, se në entet ushtarake të prapavijës punonin 49 anëtarë të Partisë, se në terrenin e këtij rrethi kishte 95 këshilla nacionalçlirimtare me 571 këshilltarë, se kishin 17 organizata të sindikatave me 1720 anëtarë, se gjatë prillit të vitit 1945 e botuan edhe numrin e parë të „Bilten-it”.<sup>13</sup> Këto të dhëna dëshmojnë se Organizata e Partisë në këtë rreth arriti suksese në stabilizimin e situatës politike dhe ndërmori masa të rëndësishme për rindërtimin e vendit.

Organizata e Partisë e rrethit të Mitrovicës së Titos zgjodhi delegatët për Konferencën e Tretë të PKJ-së për Kosovë dhe Metohi, e cila u bë në prill të vitit 1945, dhe për *Kongresin Themelues* të Partisë Komuniste të Serbisë, i cili u bë në Beograd prej 8—12 maj 1945. Në këtë Kongres u bë unjësimi i *PKJ-së të Serbisë*, *PKJ-së të Vojsodinës* dhe *PKJ-së për Kosovë dhe Metohi* dhe u formua *Partia Komuniste e Serbisë*. Organizata e Partisë në rrethin e Mitrovicës së Titos u angazhua për zbatimin e vendimeve

<sup>10</sup> *Po aty*.

<sup>11</sup> Anëtarë të Komitetit të rrethit të PKJ-së u zgjodhën: Milija Kovaçević, Milan Kërtolica, Jovan Vujović, Kadri Reufi, Franjo Dizdareviq dhe Milan Prodanoviq. Delegatë për Konferencën Krahinore të PKJ-së për Kosovë e Metohi u zgjodhën: Dragi Simonoviq, Kovilka Tojaga, Kadri Reufi, Mustafa Osmanagiq, Milan Kërtolica, Milija Kovaçević, Iljaz Cinku, Hysen Thaqi, Luka Zhivkoviq dhe Dushan Senoar, *Po aty*.

<sup>12</sup> Me këtë strukturë kombëtare: 105 serbë, 26 shqiptarë, 46 malazezë, 7 kroatë dhe 4 sllovenë. 162 mashkuj dhe 15 femra. Struktura sociale: 98 punëtorë, 49 fshatarë dhe 27 intelektual dhe 3 të tjerë.

<sup>13</sup> AIHK, Fondi OKKM, Sig. 426, nr. i dok. 2225.

dhe të detyrave që shtruan para komunistëve Konferenca e Tretë Krahinore dhe Kongresi i Parë i PK të Serbisë. Detyrë e rëndësishme ishte forcimi organizativ i Partisë. Struktura organizative e celulave për perioden 1945—1947 shihet nga kjo tabelë:

Celulat

Viti	1945	1946	1947
qyteti	5	4	7
rrethi	13	45	50 <sup>14</sup>

Krahas shtimit të numrit të celulave u shtua edhe numri i anëtarëve të Komitetit të Rrethit dhe të Komitetit të qytetit. Kjo shihet nga kjo tabelë:

Viti	1945	1946	1947
qyteti	—	8	8
rrethi	10	16	10 <sup>15</sup>

Numri i anëtarëve të Komitetit të rrethit dhe të Komitetit të qytetit nga radhët e shqiptarëve brenda kësaj periode sillej prej 1 deri në dy anëtarë. Gjatë vitit 1946 Organizata e Partisë u forcua në pikëpamje organizative. Numri i celulave u trefishua. Por, numri i anëtarëve të Partisë nga radhët e shqiptarëve ishte i vogël.

Organizatat e Partisë në rrethin e Mitrovicës së Titos në periodën 1945 dhe 1946 u angazhuan për ngritjen ideopolitike të anëtarëve dhe këtë punë e kryen në formë të organizuar në qerthuj, ku materialet e ndryshme përpunoheshin edhe nëpërmjet kurseve të ndryshme. Komunistët e këtij rrethi aktivitetin e tyre e orientuan në aftësimin, forcimin dhe në zhvillimin e organizatave politike masive në rreth dhe të organeve të pushtetit popullor.

## b. Fronti i Përbashkët Nacionalçlirimtar i Kosovës dhe i Metohisë në rrethin e Mitrovicës së Titos

Komiteti Krahinor i PKJ-së për Kosovë dhe Metohi, për stabilizimin politik në Krahinë i shtroi vetes dy detyra: formimin e or-

<sup>14</sup> AIHK, Fondi OKKM, Sig. 469, nr. i dok. 1168.

<sup>15</sup> *Po aty*, Struktura kombëtare e anëtarëve të komiteteve dhe sekretarëve të celulave shihet nga kjo tabelë:

Viti	1945	1946	1947	1948
	sh. s. m.	sh. s. m.	sh. s. m.	sh. s. m.
Celulave	1 10 2	37 7 1	16 33 1	10 36 1
Këshilli i qytetit	— — —	2 2 4	1 3 6	1 4 3
Këshilli i rrethit	1 4 5	1 7 8	2 5 1	2 5 —
Celula në qytet	— 5 —	— 1 3	— 7 —	7 28 4

ganizatave politike masive në platformën e LNÇ-së dhe formimin e organeve të pushtetit popullor. Këto detyra u përcollën në organizatat e Partisë nëpër rrethe. Në frymën e këtyre udhëzimeve veprimi edhe Komiteti i Partisë në rrethin e Mitrovicës së Titos. Këto ishin çështje thelbësore dhe nga kjo varej ruajtja e fryteve të LNÇ-së. Forcat reaksionare luftën e orientuan për çorientimin e masës popullore në forma të ndryshme. Prandaj, organizatat e PKJ-së luftonin nëpërmjet Frontit për përvetësimin e masës dhe demaskimin e platformës së forcave reaksionare të brendshme dhe të jashtme. Partia dhe Fronti i Popujve u ofronin masave të gjera çlirimin kombëtar dhe social, vëllazërimin dhe bashkimin dhe garancinë se nuk do të kthehej regjimi i vjetër. Këto mund të arriheshin me luftë kundër pushtuesit fashist në viset e tjera të vendit, me stabilizimin e situatës politike dhe me formimin e organizatave politike masive si në rreth, ashtu edhe në tërë Krahinën. Organizatat e Partisë në rrethin e Mitrovicës së Titos, sipas udhëzimeve të forumeve më të larta, duhej të angazhoheshin edhe për formimin e këshillave të Frontit të Përbashkët Nacionalçlirimtar. Për zgjidhjen e kësaj detyre Organizata e Partisë u angazhua në Këshillimin e dhjetorit të vitit 1944. Pas kësaj, u formua Këshilli i Qytetit të FPN-së dhe gjatë janarit dhe shkurtit u formua dhe veprimi Këshilli Iniciativ për kryerjen e përgatitjeve dhe formimin e Këshillit të rrethit të FPN-së. Në krye të këtij Këshilli ishte Milija Kovaçevići dhe 6 anëtarë të tjerë. Në Konferencën e PKJ-së të rrethit të Mitrovicës së Titos (8—9 mars 1945) u theksuan rezultatet e arritura dhe u shtruan detyrat.<sup>16</sup> Qytetarët e Mitrovicës së Titos me rrethinë, si edhe në viset e tjera të Krahinës, pas lajmit për qëndrimin e Petrit II Karagjorgjeviq se nuk e njeh KAÇKJ-në, organizuan protesta dhe demonstrata, i brohoriten Titos dhe KAÇKJ-së, u deklaruan për Jugosllavinë Federative Demokratike dhe u betuan se do të luftonin me vendosmëri kundër kthimit të mbretit dhe regjimit të Jugosllavisë së vjetër dhe kërkuan që „Mbretin ta gjykonte populli”.

Gjatë shkurtit dhe marsit të vitit 1945 nëpër fshatra, komuna dhe në nivel të rrethit u bënë tubime, mbledhje dhe konferenca, ku u formuan organizatat dhe u zgjodhën këshillat e Frontit të Përbashkët Nacionalçlirimtar. Në këtë punë ndihmuan organizatat e Partisë. Në fillim të prillit të vitit 1945 në Konferencën e FPN-së të rrethit të Mitrovicës së Titos u verifikua lista e delegatëve për Konferencën e Parë të Frontit të Përbashkët Nacionalçlirimtar për Kosovë dhe Metohi,<sup>17</sup> e cila u bë në Prishtinë më 10 dhe 11 prill të vitit 1945. Kjo ishte Konferenca e Parë në historinë e popujve të Kosovës dhe Metohisë ku shqiptarët, serbët dhe malazezët, të lirë dhe të barabartë, formuan *Frontin e Përbashkët Nacionalçlirimtar për Kosovë dhe Metohi*, i cili tuboi në gjirin e vet popujt për ndërtimin e marrëdhënieve socialiste. Para organizatës së Frontit u shtrua detyra që të punonte për zgjidhjen e të gjitha problemeve në frymën e kërkesave dhe të interesave popullore.

<sup>16</sup> Si shën. 7.

<sup>17</sup> Arkivi i Kosovës (AK), Fondi: Fronti Popullor, K-1.

Si organe të Frontit Nacionalçlirimtar për Kosovë dhe Metohi u botuan „Jedinstvo”, prej 20 janarit të vitit 1945, dhe „Rilindja”, prej 12 shkurtit të vitit 1945. Këto gazeta luajtën rol të rëndësishëm në përvetësimin e masës në Platformën e LNÇ-së, në zhvillimin e vëllazërimit dhe të bashkimit, të barazisë, të bashkëjetesës dhe në mobilizimin e saj për rindërtimin e vendit në tërë Krahinën, pra edhe në Mitrovicën e Titos.

Mbledhja e Këshillit Krahinor të FPN-së, e cila u bë në Pri- zren më 27 dhe 28 maj të vitit 1945, shqyrtoi punën e organizatave të FPN-së prej Konferencës Themeluese dhe u vlerësua se ishin arritur rezultate në farkimin e vëllazërimit dhe të bashkimit të popujve të Krahinës, në përfshirjen e masës në Front dhe në rindërtimin e vendit. Në këtë mbledhje FPNÇ mori mbi vete detyrën që idenë e bashkimit të Krahinës së Kosovës dhe të Metohisë me Serbinë Federale ta përhapnin në popull dhe, pas pezullimit të Qeverisjes Ushtarake, ta zbatonin në jetë në mënyrë të ligjshme. Aktivistët duhej të luftonin kundër vërejtjeve nga cilado anë që vinin.<sup>18</sup> Gjatë qershorit të vitit 1945 organizata e FPN-së të rrethit të Mitrovicës së Titos, në frymën e përfundimeve të Këshillit Krahinor të FPN-së, bëri mbledhje dhe konferenca nëpër komuna dhe fshatra duke e orientuar popullin dhe duke i shpjeguar atij orientimin e forumit më të lartë të FPN-së për Kosovë dhe Metohi dhe duke i ndihmuar për zgjidhjen e problemeve. Fronti i Përbashkët Nacionalçlirimtar i rrethit të Mitrovicës së Titos që nga ditët e çlirimit u angazhua për zgjidhjen e dy problemeve: të reformës agrare dhe të kolonistëve, nga zgjidhja e të cilave varej edhe stabilizimi i gjendjes politike në rreth. Problemi i kolonistëve u aktualizua që nga marsi i vitit 1945, kur u trajtua edhe në nivel të rrethit.<sup>19</sup> Me qëllim që këto çështje të zgjidheshin ose të zbuteshin sa më shpejt, u organizuan aksione. Kështu, gjatë qershorit të vitit 1945 organizatat e Frontit morën mbi vete që të ndërtonin 60 shtëpi të rrënuara, që fshatarëve t’ua ndanin 175 pllugje, 2.000 shata, e mblodhën 2 milionë dinarë ndihma<sup>20</sup> dhe u angazhuan që të ndihmoheshin fshatarët për kryerjen e të gjitha punëve të fushës.

Plenumi i Këshillit të Rrethit të FPN-së për Mitrovicën e Titos, që u bë më 20 qershor të vitit 1945, analizoi punën e kësaj organizate nga Konferenca Themeluese e deri në ditën kur mbahej Plenumi. Kryetari i Këshillit të Rrethit të FPN-së, Milija Cvetiniqi, paraqiti raportin e punës të Këshillit të Rrethit dhe të këshillave komunale të FPN-së. Nga raporti del se kujdesi më i madh iu kushtua rindërtimit të këtyre anëve. Shihet se kishin filluar të punonin Sharra, fabrika e tjegullave dhe e tullave e të tjera. Kujdes i veçantë iu kushtua edhe punëve të fushës me qëllim që të sigurohej ushqimi i duhur i popullsisë. Në Plenum u diskutua edhe për punën e Komitetit Nacional të Shqiptarëve për këtë rreth dhe u konstatua se me punën e vet kishte arritur suksese të dukshme

<sup>18</sup> AK, Fondi: Fronti Popullor, K-2.

<sup>19</sup> Si shën. 13.

<sup>20</sup> Arkivi i LK të rrethit të Mitrovicës së Titos (ALKMT) V-1945.

në mobilizimin e masave, sidomos për luftë kundër analfabetizimit. Njëherësh u vlerësua se dëshira dhe aktiviteti i shqiptarëve për punë në FPN ishte shtuar. Në referatin, të cilin e paraqiti Milija Kovaçevići, sekretar i Këshillit të rrethit të FPN të Mitrovicës së Titos, u përcaktuan detyrat e FPN-së si organizatë politike e masës së gjerë popullore dhe për ndihmën që duhej t'u ofronin organeve të pushtetit popullor, Komitetit Nacional të Shqiptarëve në rreth dhe për rolin që duhej ta loznin në arsimin politik të masës.<sup>21</sup> Nga të gjitha këto masa dhe aktiviteti i zhvilluar i FPN-së u krijuan mundësi për stabilizimin politik, për forcimin e organeve të pushtetit popullor dhe u krijuan kushtet që ushtarët të tërhiqeshin ngadalë në kazernat ushtarake dhe vendin e tyre ta zinin organet e pushtetit popullor.

Këshilli Krahinor i FPN-së për Kosovë dhe Metohi bashkë me Kryesinë e Këshillit Krahinor Nacionalçlirimtar për Kosovë dhe Metohi i filluan përgatitjet për mbajtjen e Kuvendit të Këshillit Krahinor Nacionalçlirimtar për Kosovë dhe Metohi. Për këtë qëllim nëpër rrethe u zgjodhën përfaqësuesit e popullit nga radhët e shqiptarëve, serbëve dhe malazezëve dhe statusin e delegatit e kishin edhe të gjithë delegatët e zgjedhur për Konferencën e Parë të Këshillit Nacionalçlirimtar për Kosovë dhe Metohi, që u bë në Bujan më 31 dhjetor 1943 dhe 1 e 2 janar 1944. Pas kësaj Kuvendi u bë në Prizren më 8, 9 dhe 10 korrik të vitit 1945 dhe morën pjesë 345 përfaqësues nga të gjitha viset e Krahinës. Në këtë Kuvend u vendos për statusin e Krahinës së Kosovës dhe të Metohisë. Kuvendi mori vendim që kjo Krahinë të bashkohej me Serbinë Federale në kuadër të Jugosllavisë Federative Demokratike<sup>22</sup> dhe për këtë u miratua Rezoluta, e cila, ndër të tjera, konstaton: „Se shqiptarët janë pjesë e popullit shqiptar, ne këtë gjë nuk e mohojmë. Këtë gjë ne e njohim, por e dimë edhe këtë, se vetë lufta e përbashkët e shqiptarëve, e serbëve dhe e malazezve në Kosovë dhe në Metohi ishte kusht i përfundimit me sukses të luftës së armatosur kundër armiqve, ashtu si edhe puna e përbashkët sot është kusht për realizimin e jetës më të mirë”.<sup>23</sup> Në punën e Kuvendit morën pjesë edhe përfaqësuesit e popullit nga Mitrovica e Titos. Në Kuvend u zgjodhën deputetët për Kuvendin Popullor të Serbisë. Nga Mitrovica e Titos u zgjodhën Ali Shukriu, Milija Kovaçevići, Milija Cvetiniqi, Kadri Reufi, Ali Boletini dhe Qazim Bajgora. Deputet i KAÇKJ-së u zgjodh Ali Shukriu, kurse zëvendës Milija Kovaçevići. Këshilltarë të Këshillit Popullor Krahinor nga rrethi i Zveçanit (Mitrovica e Titos) u zgjodhën: Milija Kovaçevići, Milija Cvetiniqi, Miladin Radulloviqi, Pera Milkoviqi, Ali Shukriu, Ahmet Mustafë Efendia, Aleksandar Nedelkoviqi, Boro Millatoviqi, Kadri Reufi, Mensur Bekteshi dhe Jakup Idrizi.

Sipas dëshirës së popullsisë të Krahinës së Kosovës dhe të Metohisë të shprehur në Rezolutën e Kuvendit Krahinor të 10 korrikut dhe sipas Rezolutës së Kuvendit të Përkohshëm Popullor të

<sup>21</sup> *Po aty.*

<sup>22</sup> Këshilli Popullor, KAKM 1943—1945, Prishtinë 1955, 46—47.

<sup>23</sup> *Po aty.*

Jugosllavisë Federative Demokratike të 10 gushtit të vitit 1945, Kryesia e Kuvendit Popullor të Serbisë miratoi më 3 shtator 1945 *Ligjin* mbi themelimin dhe rregullimin e Krahinës Autonome të Kosovës dhe të Metohisë.<sup>24</sup> Sipas këtij Ligji, Krahina ndahej në rrethe, ku bënte pjesë edhe rrethi i Zveçanit me seli në Mitrovicën e Titos. Mbi bazë të rregullimit administrativ u formuan edhe këshillat e FPN-së. Më 1945 organizata e FPN-së kishte këshillin e rrethit, këshillin e qytetit me 8 organizata themelore dhe 13 këshilla të vendit me 178 organizata themelore.<sup>25</sup> Organizata e FPN-së në rrethin e Mitrovicës së Titos zhvilloi aktivitet të madh me rastin e përgatitjeve për *Kongresin Themelues* të Frontit Popullor të Jugosllavisë, që u bë në Beograd prej 5—7 gushtit të vitit 1945. Kongresi miratoi Programin dhe Statutin e Frontit Popullor të Jugosllavisë. Nga Krahina e Kosovës u zgjodhën dhe morën pjesë në punën e Kongresit 40 delegatë, kurse nga organizata e FPN-së të rrethit të Mitrovicës së Titos Ali Shukriu dhe Milija Kovaçevići.<sup>26</sup> Në Kongres Ali Shukriu, ndër të tjera, konstatoi: „Shoku Marshal, shokë dhe shoqe, në historinë e popujve të Kosovës dhe të Metohisë shumë herë këta popuj shërbyen si monetë për të gjitha ato parti dhe grupe politike, të cilat, me ndihmën e tradhtarëve të popullit, punuan që të vinin në pushtet gjatë të të gjitha regjimeve antipopullore të Jugosllavisë së Vjetër, shpesh duke shfrytëzuar si tërësi ose individualisht popujt dhe duke thëlluar antagonizmin dhe mëninë dhe duke shfrytëzuar njërin kundër tjetrit dhe të gjithë së bashku. E vetmja Parti, e cila mbajti në mënyrë konsekuente dhe pandërprerë gjatë tërë kohës së ekzistimit të Jugosllavisë së Vjetër interesat e shqiptarëve dhe të popujve të tjerë, ishte Partia Komuniste e Jugosllavisë. Popujt tanë të Kosovës dhe të Metohisë dhe sidomos populli shqiptar, shohin në Frontin Popullor, në të cilin Partia Komuniste është më e forta dhe themel i sigurt, një garanci për mundësinë që t'i realizojnë dëshirat e veta dhe të sigurojnë lirinë dhe barazinë me të gjithë popujt e tjerë të Jugosllavisë.

Organizata e Frontit Popullor tek ne përfshin të gjitha organizatat antifashiste sikurse edhe në vendet e tjera të Jugosllavisë. Në Frontin Popullor ndodhet edhe Komiteti Nacional i Shqiptarëve, si organizatë e shqiptarëve, dhe është pjesë përbërëse e Frontit që ka për detyrë që sa më shpejt dhe në mënyrë më efektive t'ia bëjë të mundshme popullit shqiptar ngritjen politike dhe kombëtare në bashkësi me popujt e tjerë të Jugosllavisë. Të gjitha këto organizata në Frontin Popullor kërkojnë vijën unike politike. Frontin popujt tanë e pranuan si formë më të përshtatshme të organizatës politike, nëpërmjet të cilës në mënyrë më të sigurt mund të ngriten në pikëpamje politike dhe kombëtare. Parimet e propozuara të Statutit të Frontit Popullor, që plotësisht i përgjigjen, do t'ia bëjnë të mundshme Frontit Popullor tek ne që si tërësi të forcohet bashkë me organizatat e tjera antifashiste dhe Komitetin

<sup>24</sup> *Službeni glasnik Srbije*, nr. 28, Beograd 1945.

<sup>25</sup> Si shën. 20.

<sup>26</sup> Arkivi i Jugosllavisë (AJ), Shënime Stenografike të Kongresit Themelues të FPJ-së.

Shqiptar dhe përbrenda të forcojnë Frontin e t'i kryejmë detyrat që shtrohen para nesh. Kjo është garanci që popujt tanë nëpërmjet Frontit t'i realizojnë të gjitha ato detyra që shtron Programi i Frontit, të cilin ne e pranojmë dhe për realizimin e tij do të punojmë me të gjitha forcat e popujve tanë në Kosovë dhe në Metohi".<sup>27</sup>

Nga analiza e diskutimit del se Fronti Popullor në Kosovë dhe në Metohi, si edhe në viset e tjera të vendit, ishte i gatshëm t'i realizonte detyrat, të shprehte synimet dhe t'i plotësonte dëshirat e popujve të Krahinës së Kosovës dhe të Metohisë. Njëherësh ai pranonte Programin e Frontit Popullor të Jugosllavisë me të cilin bashkohej në Kongresin Themelues të tij. Nga ana tjetër, me Program krijohet baza për ngritjen politike dhe afirmimin kombëtar, sidomos të shqiptarëve, të cilët deri në këtë kohë nuk gëzonin lirinë dhe barazinë, kurse Komiteti Nacional i Shqiptarëve, si organizatë politike e tyre në kuadër të Frontit Popullor, ishte bazë reale për ngritjen politike dhe kombëtare të shqiptarëve.

Josip Broz Tito ua bëri me dije delegatëve në Kongres se puna e Frontit në të ardhmen duhej të orientohej në përgatitjet për shpalljen e Jugosllavisë Federative Demokratike — Republikë, por kjo duhej të kryhej me zgjedhje të lira dhe demokratike. Më 22 gusht të vitit 1945 u miratua Ligji për zgjedhjen e deputetëve popullorë për Kuvendin Kushtetues dhe u caktuan zgjedhjet për 11 nëntor 1945. Me këtë filloi fushata parazgjedhore dhe zgjedhore. Me këtë vendosej edhe forma e sistemit — republikë apo monarki. Organizimin e zgjedhjeve e bëri Fronti Popullor. Sipas Vendimit të Komisionit Zgjedhor Federativ, KAKM-ja zgjedhte 14 deputet për Kuvendin Federativ dhe 10 deputet për Kuvendin e Popujve. Komisioni zgjedhor i KAKM-së më 6 shtator 1945, në mbledhjen që u bë në Prizren, miratoi vendimin me të cilin Krahina ndahej në 2 qarqe zgjedhore. Në qarkun e parë zgjedhor të Kosovës u caktuan këto rrethe: i Graçanicës, i Llapit, i Vuçitërnës, i Mitrovicës së Titos dhe i Drenicës dhe çdo rreth zgjedhte nga një deputet. Në plenumin e Këshillit Krahinor të Frontit Popullor, që u bë në Prizren më 18 shtator 1945, u caktua lista kandiduese. Sipas kësaj liste, në rrethin zgjedhor të Mitrovicës së Titos kandidat u caktua Milija Cvetiniqi, mësues, kurse zëvendës Ahmet Mustafa Efendia. Në plenum u caktua edhe lista e kandidatëve dhe e zëvendësve të tyre për Kuvendin e Popujve dhe bartës i listës ishte Ali Shukriu. Gjatë tetorit të vitit 1945 u bënë zgjedhjet për këshillat popullorë të vendeve dhe të rretheve. Kandidatët u caktuan në mbledhjet e këshillave të Frontit. Në këto zgjedhje në Mitrovicën e Titos votuan 85,5 për qind. Rreth përgatitjes së zgjedhjeve në Mitrovicën e Titos u bë një miting popullor, ku folën Milija Kovaçeviqi, majori Bozho Zharkoviqi, dr. Vladimir Vuksanoviqi dhe në gjuhën shqipe Eshref Tërziqi. Në miting morën pjesë 2.500 veta.<sup>28</sup> Me Ligjin mbi zgjedhjet, që e miratoi Kuvendi i Përkohshëm

<sup>27</sup> Po aty.

<sup>28</sup> Kryetar i Këshillit të rrethit të Frontit Popullor ishte dr. Vladimir Vuksanoviç. „Jedinstvo“, 2 nëntor 1945.

Popullor, u sigurua e drejta e votimit edhe për të rinj dhe gra. Fronti Popullor edhe në rrethin e Mitrovicës së Titos zhvilloi aktivitetet dhe luftë për daljen e grave në votime. Me këtë thyhej tradita ngase gratë ishin të mbuluara, por mosdalja e tyre ishte pengesë e madhe sepse gjysma e popullsisë shqiptare do të mbetej anash e në këtë Front nuk do të fitonte shumicën. Puna dhe rezultate dhe gratë me çarçaf dolën në votime dhe votuan për listën e Frontit. Votimet u bënë më 11 nëntor 1945. Kjo ishte krenite, por edhe fitore. Në rrethin e Mitrovicës së Titos votuan 97,63 për qind. Për kandidatët e Frontit Popullor për Kuvendin Kushtetues votuan 92,24 për qind dhe në kutinë pa lista 5,76 për qind. Për kandidatët e Frontit Popullor për Kuvendin e Popujve votuan 90,23 për qind dhe për kutinë pa lista 9,97 për qind. Nga kjo del se fitoi Fronti Popullor. Milija Cvetniqi fitoi 13.724 vota, kurse Savo Çalakoviqi 2.893 vota<sup>29</sup> dhe deputet u zgjodh Milija Cvetniqi — Kuvendi Kushtetues. Më 29 nëntor 1945 deputetët miratuan Vendimin që Jugosllavia të shpallej Republikë dhe të quhej Republika Federative Popullore e Jugosllavisë. Me këtë u hoq monarkia në Jugosllavi. Kuvendi Kushtetues filloi punën për hartimin e Kushtetutës dhe pas diskutimit publik rreth Projektit të Kushtetutës së RFPJ-së. Kushtetuta u miratua më 31 janar 1946. Kjo ishte fitore dhe kurorëzim i fryteve të Luftës Nacionalçlirimtare. Për këtë rol të rëndësishëm luajti Fronti Popullor i Jugosllavisë me Titon në krye. Karakteristika themelore e organizimit shtetëror në Kushtetutë shprehej në parimet pushteti unik dhe demokratizmi centralist. Sistemi i ekonomisë kishte karakter të përzier dhe përbëhej nga pronësia shtetërore, kooperativiste dhe private. Por dominonte sektori shtetëror me fuqi ekonomike dhe përkrahje nga pushteti dhe nga organizatat politike masive.

Fronti Popullor në periudhën e rindërtimit luajti rol të rëndësishëm si për ndihmën që u jepte organeve të pushtetit për kryerjen e planit të rindërtimit, ashtu edhe me planet e veta Fronti Popullor këto ndihma i ofronte nëpërmjet punës vullnetare. Për këtë arsye formoheshin brigada pune që punonin për meremetimin dhe ndërtimin e rrugëve, urave, shkollave, shtëpive për kolonista, ujësjellës dhe punë të tjera. Në kuadër të Frontit me punë vullnetare u dalluan organizatat e rinisë dhe shoqatat sindikale. Që punët të kryheshin me sukses organizoheshin edhe garat socialiste. Garat organizoheshin në ndërmarrje, punëtori, xeherore, ente, spitale, në qytet dhe nëpër fshatra, kudo ku e kërkonte nevoja. Në rrethin e Mitrovicës së Titos sidomos dallohej Shoqata e Sindikatave në Stari Tërg dhe ajo e Shkritesor në Zveçan dhe brigadat e ndërtimtarëve për meremetimin dhe ndërtimin e shtëpive në fshatra dhe në qytete dhe u shpallën sulmues. Organizatat e Frontit dhe organet e pushtetit ndihmuan që në Mitrovicën e Titos të hapej ambulanca poliklinike me seksionet për praktikë të përgjithshme, pediatri, otorinolaringologji, për sëmundje të dhëmbëve dhe sëmundje profesionale.<sup>30</sup> Për sukseset e arritura në punë vull-

<sup>29</sup> AK, Fondi: Fronti Popullor, K-5, 1945.

<sup>30</sup> AIHK, K-2.

netare, „Trepça” u shpall kolektivi punonjës më i mirë në Serbi dhe mori flamurin kalimtar.<sup>31</sup> Rinia e Mitrovicës së Titos dha kontributin e vet me punë vullnetare në rreth, Krahinë dhe në aksionet federative të rinisë.

Organizata e Frontit Popullor të rrethit të Mitrovicës së Titos, krahas punës në rindërtimin e vendit, rëndësi të madhe i kushtoi punës ideopolitike, organizative, kulturo-arsimore, emancipimit të femrës, zgjidhjes së çështjeve pronësore dhe punës së organizatave të tjera politike masive që punonin në kuadër të Frontit. Para organizatave të Frontit shtrohej detyrë edukimi politik dhe kulturo-arsimor i masës. Për këtë qëllim u formuan aktivet e agjitorëve. Prandaj në rrethin e Mitrovicës së Titos, në prill të vitit 1945, punonin 5 këshilla kulturore, 1 universitet i punëtorëve, 13 shtëpi të rinisë, një kurs profesional në fabrikën „Trepça”, 10 kurse për mësimin e shkrimleximit, 8 shkolla fillore, 1 gjimnaz, u dhanë 81 shfaqje, punonin 8 biblioteka dhe salla leximi dhe shpërndahej e lexohej shtypi, kurse me rastin e përgatitjeve për Një Maj u botua „Buletini” në gjuhën serbokroate.<sup>32</sup> Me qëllim që detyrat e shtruara të kryheshin sa më mirë, në Këshillin e rrethit u formuan aktive dhe komisione, si për agjitacion dhe propagandë, për luftë kundër analfabetizmit dhe për organizimin e ndihmave shoqërore.

Fronti Popullor i Serbisë në gjysmën e dytë të vitit 1946 organizoi zgjedhjet për Kuvendin Kushtetues të Republikës Popullore të Serbisë. Zgjedhjet u bënë më 10 nëntor 1946. Në shpalljen<sup>33</sup> e FPS-së për Kosovë dhe Metohi u dhanë rezultatet më të rëndësishme që ishin arritur për forcimin ekonomik, ngritjen ideopolitike, kulturo-arsimore, klasore dhe për afirmimin kombëtar. Që kjo punë të kryhej sa më mirë, Këshilli i rrethit bëri konferencën e vet, ku u zgjodhën kandidatët dhe zëvendësit e tyre për deputetë të Kuvendit Kushtetues të RP të Serbisë: Kërsta Filipoviqi dhe zëvendës Xhabir Mustafa, kandidat i dytë Abdi Rushiti dhe zëvendës Marko Gjuriqi, kandidat i tretë Savo Nedelkoviç dhe zëvendës Hamza Katrica dhe u arritën këto rezultate duke votuar 98,95 për qind<sup>34</sup> dhe u zgjodh deputet Kërsta Filipoviqi.

Fushata zgjedhore për Kuvendin Kushtetues të RPS-së mobilizoi organizatat e Frontit që të forcohej në pikëpamje organizative e të luftonin për ngritjen ideopolitike dhe kulturo-arsimore të masës. Në këtë kohë u botua edhe *Abetarja e Parë* për mësimin e shkrimleximit. Abetarja lehtësoi punën me analfabet. Rëndësi të madhe kishte edhe miratimi i Ligjit mbi martesat,<sup>35</sup> sidomos për shqiptarët muslimanë dhe katolikë, pastaj Ligji për blerjen e dritit dhe Ligji për nacionalizimin e ndërmarrjeve ekonomike private.

<sup>31</sup> Flamuri iu dorëzua Murat Osmanit — sulmues i trefishtë në Konferencën e Dytë të Sindikatave të Kosovës.

<sup>32</sup> Si shën. 13.

<sup>33</sup> „Rilindja”, 6 nëntor 1946.

<sup>34</sup> Në rrethin e parë të zgjedhjeve Kërsta Filipoviç fitoi 16.296 vota, Abdi Rushiti 1289 dhe Sava Nedelkoviç 1922 vota.

<sup>35</sup> Ali Shukriu, *Rëndësia e Ligjit të Ri të martesës për shqiptarët e Kosmetit*, „Përparimi”, nr. 2, 1946, 25.

Fronti Popullor në periudhën e rindërtimit të rrethit të Mitrovicës së Titos korri fitore të shumta dhe ndihmoi punën e subjekteve të tjera të organizuara socialiste.

### c. Organizatat e rinisë në rrethin e Mitrovicës së Titos

Të rinjtë e rrethit të Mitrovicës së Titos në platformën e LNÇ-së punonin në dy organizata të rinisë: Bashkimin e Rinisë Komuniste të Jugosllavisë për Kosovë dhe Metohi dhe në Bashkimin e Unjësuar të Rinisë Antifashiste të Jugosllavisë për Kosovë dhe Metohi. BRKJ-ja në rrethin e Mitrovicës së Titos veproi para Luftës së Dytë Botërore dhe gjatë Luftës Nacionalçlirimtare.<sup>36</sup> BRKJ-ja pas çlirimit të Mitrovicës së Titos vazhdoi punën në mënyrë kontinuitive. Numri i tyre shtohet dita-ditës dhe në prill të vitit 1945 organizata e BRKJ-së në rrethin e Mitrovicës së Titos arrinte në 405 anëtarë.<sup>37</sup> Organizata kishte strukturën organizative në nivel të rrethit dhe të qytetit dhe punonin nëpër celula. Për punën e BRKJ-së kujdeseshin organizatat e PKJ-së, ku kishin angazhuar drejtpërdrejtë 25 anëtarë të Partisë. Skojistët ishin të parët për kryerjen e detyrave që u shtruan për stabilizimin e situatës politike në rreth, forcimin e organeve të pushtetit popullor dhe për rindërtimin e rrethit dhe më gjerë. BRKJ kishte detyrë parësore për vetësimin e rinisë në platformën e LNÇ-së dhe për rindërtimin e vendit. Për këtë qëllim ajo u angazhua për formimin e Bashkimit të Unjësuar të Rinisë Antifashiste të Jugosllavisë për Kosovë dhe Metohi dhe në rrethin e Mitrovicës së Titos.

Bashkimi i Unjësuar i Rinisë Antifashiste të Jugosllavisë për Kosovë dhe Metohi u formua në Konferencën e Parë, e cila u bë në Gjakovë më 17 dhe 18 nëntor 1945. Detyrë e parë ishte forcimi organizativ dhe nga kjo rezultoi se aktiviteti u orientua në formimin e organizatave nëpër rrethe. Skojistët morën mbi vete detyrën për formimin e këshillit iniciativ në nivel të rrethit dhe të qytetit të Mitrovicës së Titos. Këshillat e kryen me sukses punën e tyre dhe në janar të vitit 1945 u formuan disa këshilla të BURAJ-të në qytet dhe në fshatra. Organizata e BURAJ-të e mobilizoi rininë për ta ndihmuar UNÇJ-në dhe rreth rindërtimit të vendit të bashkuar shqiptarë, serbë dhe malazezë. Organizatat e BURAJ-t në rreth mblodhën ndihma për ushtri, kujdeseshin për familje të varfura, invalidë dhe të tjera. Organizatat e rinisë aktivitetin e vet për rindërtimin e vendit e zhvillonin bashkë me organizatat e Frontit, prandaj nuk po e trajtojmë në mënyrë të veçantë. Organizatat e rinisë së këtij rrethi morën pjesë edhe në aksionet punuese në Kosovë dhe në Jugosllavi, si për ndërtimin e hekurudhave Metohi-Prizren, Bellaqevc-Golesh, në Bosnje, Beograd dhe gjetiu.

<sup>36</sup> Si shën. 2, 400—402.

<sup>37</sup> Si shën. 13.

## **ç. Fronti Antifashist i Grave i Kosovës dhe Metohisë në rrethin e Mitrovicës së Titos**

Fronti Antifashist i Grave në rrethin e Mitrovicës së Titos pas çlirimit të rrethit të tyre e vazhdoi në mënyrë kontinuitive punën e filluar gjatë LNÇ-së. Organizatat e Partisë ndihmuan në orientimin e punës së FAG-ut dhe forcimin e tyre organizativ. Filluan të formohen këshillat e FAG-ut në qytet, fshatra dhe më në fund edhe në nivel të rrethit të Mitrovicës së Titos. Në Konferencën e rrethit të Partisë, që u bë më 8 dhe 9 mars 1945, u konstatua se numri i grave anëtarë të PKJ-së prej gjithsej 15 veta ishte i vogël<sup>38</sup> dhe se organizata e Partisë duhej të bënte përpjekje për shtimin e numrit të tyre dhe të mobilizohej për ngritjen ideopolitike dhe kulturo-arsimore të tyre dhe të luftohej për emancipimin e femrës në tërësi, e në mënyrë të veçantë të asaj shqiptare. Për këtë qëllim organet e Frontit, „Rilindja” dhe „Jedinstvo”, botuan artikullin „Edhe shqiptarja ec në rrugën e përparimit”.<sup>39</sup> Ky ishte orientim për ditët e reja dhe marrëdhënie të reja drejt emancipimit.

Këshilli i FAG-ut të rrethit të Mitrovicës së Titos në mars zgjodhi delegatët për Konferencën Themeluese të FAG-ut për Kosovë dhe Metohi. Konferenca u bë në Prishtinë më 20 mars 1945, ku morën pjesë rreth 400 delegatë dhe mysafirë. Konferenca shtroi detyrat për punë në të ardhmen. Përfaqësueset e FAG-ut në Konferencën Themeluese të FPN-së u deklaruan se do ta ndihmonin punën e Frontit dhe se anëtarësoheshin në të në mënyrë kolektive.

Organizatat e FAG-ut të rrethit të Mitrovicës së Titos ndihmuan në stabilizimin e gjendjes politike, në hapjen e kurseve për mësimin e shkrimleximit, punën e shoqërive kulturo-artistike, i dhanë ndihmë ushtrisë, por edhe për rindërtimin e vendit të shkatërruar nga lufta. Njëherësh, me daljen e tyre masive në zgjedhjet e 11 nëntorit të vitit 1945 vërtetuan orientimin e vet duke votuar për listën e Frontit Popullor të Jugosllavisë dhe shpalljen e Republikës. Po në mënyrë masive dolën edhe në votimet e 10 nëntorit të vitit 1946 dhe votuan për listën e Frontit Popullor të Serbisë për deputetët e Kuvendit Kushtetues të Republikës Popullore të Serbisë. Puna e FAG-ut në rrethin e Mitrovicës së Titos ishte e pandashme nga puna e Frontit Popullor të rrethit, prandaj ashtu edhe do të trajtohet.

## **d. Komiteti Nacional i Shqiptarëve të Kosovës dhe të Rrafshit të Dukagjinit në rrethin e Mitrovicës së Titos**

Pas çlirimit të Krahinës së Kosovës dhe të Rrafshit të Dukagjinit ndihej nevojë e madhe për organizimin e masës së gjerë popullore në tërësi dhe në mënyrë të veçantë të asaj shqiptare. Kërkesa për organizimin dhe përfshirjen e shqiptarëve në organizata po-

<sup>38</sup> Struktura sociale e grave anëtarë të Partisë ishte: 6 intelektuale, 2 fshatare, 2 punëtore dhe 5 armive.

<sup>39</sup> „Jedinstvo”, 1 mars 1945.

litike masive e shtruan kuadrot e PKJ-së për Kosovë e Metohi si para lufte, ashtu edhe gjatë Luftës Nacionalçlirimtare. Vërtet gjatë LNÇ-së në disa vise të Krahinës u formuan dhe punuan organizata të PKJ-së të përbëra vetëm nga shqiptarët. Këtë punë e vazhduan edhe organizatat e tjera dhe Këshillat Nacionalçlirimtare. Mirëpo, pas çlirimit nevojitej mobilizim i gjerë për vazhdimin e luftës deri në çlirimin definitiv të Jugosllavisë dhe për stabilizimin politik në Krahinë, me të cilin siguroheshin frytet e LNÇ-së. Për këtë u ndie nevojë për formimin e një organizate politike masive të shqiptarëve, e cila do t'i organizonte shqiptarët në Platformën e Frontit të Përbashkët Nacionalçlirimtar për Kosovë e Metohi. Komiteti Krahinor në bashkëpunim me Komitetin Qendror të PKJ-së i filloi përgatitjet e përgjithshme dhe përcaktoi formën organizative. Për këtë qëllim, përkatësisht për zbatimin në jetë të vendimit për formimin e një organizate politike masive të shqiptarëve u angazhuan komunistët në tërë Krahinën. Në konferencat e rretheve të PKJ-së u njohtuan komunistët për vendimin e Komitetit Qendror të PKJ-së dhe para tyre u shtrua si detyrë që me të gjitha forcat të angazhoheshin në formimin e Komitetit Nacional të Shqiptarëve të Kosovës dhe të Rrafshit të Dukagjinit. Kështu, në konferencën e rrethit të PKJ-së në Mitrovicën e Titos, e cila u bë më 8 dhe 9 mars të vitit 1945, Miladin Popoviqi, sekretar i Komitetit Krahinor të PKJ-së për Kosovë e Metohi, i njohtoi delegatët për nevojën e formimit të organizatës politike masive të shqiptarëve me emrin Komiteti Nacional i Shqiptarëve të Kosovës dhe të Rrafshit të Dukagjinit dhe para organizatës së Partisë të këtij rrethi u shtrua detyrë që të ndihmonin formimin e tij.<sup>40</sup> Kjo masë u përkrah nga delegatët e konferencës së Partisë dhe ishte detyrë pune në të ardhmen. Organizatat e Partisë në rrethin e Mitrovicës së Titos gjatë marsit organizuan tubime të ndryshme me shqiptarë, ku flitej për situatën politike në vend dhe shpjegohej nevoja për organizimin e popullit shqiptarë për kryerjen e të gjitha detyrave që shtroheshin para tyre, si për luftë kundër armikut, ashtu edhe për rindërtimin e vendit. Në mbledhjet që u bënë kërkohej që të zgjedheshin edhe delegatët për tubimin e përgjithshëm, që duhej të bëhej në nivel të Krahinës për konstituimin e organizatës politike masive të shqiptarëve. Si në Mitrovicën e Titos, ashtu edhe në rrethet e tjera të Krahinës, u zgjodhën delegatët dhe Konferenca Themeluese e Komitetit Nacional të Shqiptarëve të Kosovës dhe të Rrafshit të Dukagjinit u bë në Prishtinë më 27 dhe 28 mars të vitit 1945 në praninë e rreth 400 delegatëve dhe mysafirëve.<sup>41</sup> Delegatët në Konferencë trajtuan situatën politike në Krahinë dhe caktuan detyrat për punë në të ardhmen. Detyrat e KNSH-së ishin: afirmimi kombëtar, çlirimi social, ngritja politike, kulturo-arsimorë, mësimi i historisë dhe i kulturës së popullit shqiptar, të ndihmonte organet e pushtetit popullor në zgjidhjen e të gjitha problemeve në frymën e interesave dhe të kërkesave të popullit.

<sup>40</sup> Si shën. 7.

<sup>41</sup> „Rilindja”, 5 prill 1945.

Formimi i Komitetit Nacional të Shqiptarëve ishte një ndër ngjarjet e rëndësishme në historinë e popullit shqiptarë në Kosovë dhe në Rrafsh të Dukagjinit. Formimi i tij më së miri e karakterizon madhësinë e fitores gjatë LNÇ-së kundër okupatorit fashist dhe ndihmësve të tij. Me këtë shpjegohet dhe vërtetohet thirrja e PKJ-së për Luftë Nacionalçlirimtare drejtuar të gjithë popujve të Jugosllavisë më 4 korrik të vitit 1941. Pra, kjo ishte edhe rezultat i LNÇ-së i mbështetur në thirrjen e PKJ-së se të gjithë duhet të luftojnë për të siguruar barazinë dhe lirinë. Kjo krijoi mundësi që në Jugosllavinë Demokratike Federative të realizohej vëllazërimi dhe bashkimi i popujve tanë. Prandaj, formimi i Komitetit Nacional të Shqiptarëve ishte pranim i të drejtave kombëtare, kulturore dhe ekonomike për shqiptarët në Kosovë dhe në Rrafsh të Dukagjinit, e kjo do të thotë pranim i të gjitha atyre të drejtave që një popull e bëjnë të lirë dhe të barabartë. Komiteti Nacional i Shqiptarëve ishte fryt i luftës shumëvjeçare të popujve tanë që jetojnë të vëllazëruar e të bashkuar dhe të lirë. Ky Komitet u formua duke u mbështetur në përvojën e hidhur në të kaluarën, e cila mohonte të drejtat kombëtare të një populli që përbënte shumicën në këtë Krahinë, duke varrosur marrëdhëniet e ndërsjella vëllazërore dhe duke zhvilluar shovinizmin e me të varroste dhe uzurponte lirinë e të gjithë popujve. Në një përfundim të tillë erdhi udhëheqja e Kosovës dhe e Rrafshit të Dukagjinit më 1945. duke u mbështetur në parimin që shtruan klasikët e marksizmit se populli që shtyp tjetrin — nuk është as vetë i lirë.<sup>42</sup> Prandaj, vetëm me zgjidhjen e drejtë të çështjes kombëtare duke u çënë të drejta të njëjta të gjithë popujve për jetën kombëtare dhe kulturore, është e mundshme të sigurohet liria, e cila është një dhe e pandashme për të gjithë.

Komiteti u angazhua me të gjitha organet e veta, si në nivel të Krahinës, ashtu edhe nëpër rrethe e deri te organizata themelore, për zgjidhjen e reformës agrare me qëllim që asnjë fshatar shqiptar dhe serb — vendas të mos mbeste pa tokë. Njëherit duhej të ndihmonte edhe për zgjidhjen sa më të drejtë të problemit të kolonistëve.

Komiteti Nacional i Shqiptarëve shtroi para vetes si çështje të rëndësishme ngritjen kulturo arsimore dhe forcimin e vetëdijes kombëtare. Njëherësh u angazhua edhe për forcimin e vëllazërimit dhe bashkimit të popujve të Kosovës (shqiptarëve, serbëve dhe malazezëve) dhe të Jugosllavisë, si tërësi.

Formimin e Komitetit populli shqiptar i Kosovës dhe i Rrafshit të Dukagjinit e priti dhe e përshëndeti me kënaqësi. Kjo ishte me rëndësi të madhe ngase ishte garanci se detyrat e shtruar do të kryheshin me sukses, e kjo ishte bazë e Komitetit për të shtruar të gjitha interesat dhe kërkesat e popullit që deri atëherë kishte jetuar në robëri. Çlirimi nga sundimet antipopullore dhe vendosja e marrëdhënieve socialiste ua bëri të mundshme shqiptarëve të Kosovës dhe të Metohisë që të gëzonin rilindjen e vet.

<sup>42</sup> Fehmi Pushkolli, *Qëndrimi i klasikëve të marksizmit ndaj Çështjes Lindore, „Kosova-Kosovo”, nr. 3, Prishtinë 1974, 437—306*

Përfaqësuesit e Komitetit Nacional të Shqiptarëve të Kosovës dhe të Rrafshit të Dukagjinit e përshëndetën Konferencën Themeluese të Frontit të Përbashkët Nacionalçlirimtar (10—11 prill 1947) dhe u deklaruan se KNSH-ja miraton dokumentet e FPN-së të posformuar dhe se do të anëtarësohen në mënyrë kolektive dhe do të punojnë në kuadër të tij. Nga kjo del se KNSH-ja vepronte në frymën e Platformës së FPN-së dhe se shqiptarët ishin të anëtarësuar në FPN dhe KNSH. Me këtë shihet se Komiteti Nacional i Shqiptarëve kishte statusin e organizatës politike masive të shqiptarëve, por veprimtaria e tij ishte e koordinuar në suazat e politikës së përgjithshme të FPN-së si organizatë politike masive e të gjithë popujve të Kosovës dhe të Metohisë dhe i cili në gjirin e vet përfshinte PKJ-në, BRKJ-në, BURAJ-në, FAG-un, KNSH-në dhe organizata të tjera që u formuan më vonë: Rininë Shqiptare të Kosovës dhe të Rrafshit të Dukagjinit dhe Lidhjen e Unjësuar të Sindikatave të Punëtorëve dhe të Nëpunësve të Kosovës dhe të Metohisë.

Komiteti Nacional i Shqiptarëve të Kosovës dhe të Rrafshit të Dukagjinit bashkë me Komitetin Krahinor të PKJ-së për Kosovë e Metohi bëri përgatitje të nevojshme dhe e nisi për Beograd delegacionin e zgjedhur në Konferencën Themeluese të KNSH-së të takohet me Mareshalin Tito. Nga rrethi i Mitrovicës së Titos në delegacion ishte edhe Ahmet Efendija.

Mareshali Tito e pranoi delegacionin e KNSH-së më 4 prill 1945 dhe me të bisedoi disa orë. Shoku Tito i dëgjoi me vëmendje delegatët e KNSH-shë, të cilët folën për problemet kyçe të punës, zhvillimit, afirmimit, të të drejtave, barazisë, vëllazërimit dhe bashkimit, simboleve kombëtare, arsimit në gjuhën amtare, reformës agrare dhe kolonizimit, kulturës dhe çështjeve të tjera me rëndësi për çlirimin kombëtar dhe klasor të popullit shqiptar të Kosovës dhe të Rrafshit të Dukagjinit. Lidhur me to Mareshali Tito shtoi: „Ne po formojmë Jugosllavinë e Re, e cila do të jetë tjetër për shqiptarët e Kosovës dhe të Metohisë nga ajo që ishte Jugosllavia e vjetër. Ne po formojmë shtetin e ri në të cilin shqiptarët do të ndihen qytetarë të harabartë dhe nuk do të nënçmohen prej askujt. Që të formohet Jugosllavia e tillë na është e nevojshme ndihma e popullit shqiptar. . . Kosova dhe Metohia ishin gur i pengesës dhe çrregulluan marrëdhëniet ndërmjet popujve dhe sunduesve. . . Ne dëshirojmë që ai popull më të mos ndiqet. Populli shqiptar është krenar, punëtorë dhe i ndershëm dhe duhet të jetë faktor i rëndësishëm në ndërtimin e Jugosllavisë së Re. . . Armiaqët e bashkimit tonë po mundohen të kthejnë shqiptarët nga rruga e drejtë, nga vija e luftës sonë, e kjo është vëllazërimi dhe bashkimi i popujve tanë. . . Populli shqiptar duhet ta dijë se do t'i ofrohen të gjitha mundësitë ta zhvillojë dhe ndërtojë kulturën e vet, të fitojë shkollat e veta, ta përparojë bujqësinë e vet. Populli shqiptar në Jugosllavinë e Re do t'i fitojë të gjitha ato që një popull e bëjnë popull. Popujt e Kosovës dhe të Metohisë duhet ta realizojnë vëllazërimin e bashkimitin e tillë që për popullin shqiptar të jetë krejt një se a gjendet në kufijtë e Shqipërisë ose të

Jugosllavisë. . . Përcillni porosinë popullit shqiptar të Kosovës dhe të Metohisë dhe përshëndetjet më të mira që ne do të bëjmë çdo gjë që kushtet sa më parë të konsolidohen dhe që populli shqiptar të ndihet i barabartë me popujt e tjerë të Jugosllavisë. Do të ketë ende vështirësi, por ne bashkërisht do t'i tejkalojmë".<sup>43</sup>

Delegacioni i KNSH-së u nda nga Mareshali Tito i bindur se tregoi mirëkuptim të plotë ndaj zgjidhjes së problemeve të kësaj Krahine dhe në mënyrë të qartë shprehu simpatinë ndaj popullit shqiptar, i cili ishte i shtypur në periudhat e mëparshme të historisë së vet. Edhe kjo vizitë tregoi se marrëdhëniet ndërmjet popujve të Kosovës dhe të Rrafshit të Dukagjinit dhe popujve të tjerë të Jugosllavisë do të zhvillohen në ruajtjen e fryteve të LNÇ-së.

Gjatë majit të vitit 1945 në rrethin e Mitrovicës së Titos u bënë konferencat e organizatave themelore, të komiteteve të vendit, të komitetit të qytetit dhe konferenca e rrethit e Komitetit Nacional të Shqiptarëve. Në mbledhje, konferenca e tubime u zgjodhën forumet e Komitetit Nacional të Shqiptarëve. Struktura organizative ishte: organizata themelore, komitetet e vendit, komiteti i qytetit dhe komiteti i rrethit. Komitetet kishin edhe sekretariatet si organe politike ekzekutive. Puna e tillë bëri që të forcohen në pikëpamje organizative dhe të aftësohen për kryerjen e të gjitha detyrave që shtroheshin para Komitetit Nacional të Shqiptarëve në rrethin e Mitrovicës së Titos.

Komiteti Nacional i Shqiptarëve në rrethin e Mitrovicës së Titos gjatë vitit 1945 u angazhua për stabilizimin e situatës politike, në punën kulturo-arsimore dhe në ngritjen ideopolitike të shqiptarëve. Organizatat e këtij Komiteti me aktivitetin e vet kontribuan që të arrihen fitore me rastin e zgjedhjeve të 11 nëntorit të vitit 1945 duke votuar për listën e Frontit Popullor. Gjatë vitit 1946 në mënyrë të veçantë u angazhua për ngritjen e nivelit kulturo-arsimor të popullit shqiptar në këtë rreth. U hapën kurse për mësimin e shkrimleximit, u organizuan shoqëri kulturo-artistike dhe u hapën biblioteka dhe salla të leximit. Organizatat e Komitetit Nacional të Shqiptarëve i kishin shtruar vetes detyrë të mobilizoheshin dhe të merrnin pjesë aktive për zgjidhjen e problemit të kolonistëve dhe sidomos ndihmuan për ndërtimin e shtëpive të tyre. Me këtë vërtetuan se ishin orientuar për zhvillimin dhe thellimin e vëllazërimit dhe të bashkimit ndërmjet popujve të këtij rrethi dhe më gjerë.

Komiteti Nacional i Shqiptarëve në rrethin e Mitrovicës së Titos, si edhe në tërë Krahinën, ishte orientuar dhe bënte punë të koordinuara në kuadër të Frontit Popullor, prandaj puna e organizatave të tij do të trajtohet në tërësinë e punës së Frontit.

<sup>43</sup> „Politika”, Beograd 7 prill 1945; „Glas”, Beograd, prill 1945.

## **dh. Rinia Shqiptare e Kosovës dhe e Rrafshit të Dukagjinit në rrethin e Mitrovicës së Titos**

Komiteti Krahinor i PKJ-së për Kosovë dhe Metohi me qëllim që të aktivizonte sa më shumë rininë shqiptare miratoi vendimin për formimin e një organizate politike masive të tyre. Organizata duhej të luante atë rol për rininë shqiptare që kishte KNSH-ja për shqiptarët në tërësi. Në këtë drejtim duhej t'u ndihmonin organizatat e BRKJ-së dhe BURAJ-të në tërë territorin e Krahinës. Me qëllim që kjo punë të kryhej sa më shpejt dhe me sukses u formua Këshilli Iniciativ, të cilin e përbënin aktivistë të dalluar anëtarë të PKJ-së, BRKJ-së, BURAJ-të, KNSH-së dhe FPN-së për Kosovë dhe Metohi. Ky Këshill përcaktoi formën organizative dhe përmbajtjen e tubimeve nëpër rrethe ku do të zgjidheshin delegatët. Pas kësaj, më 30 prill të vitit 1945, u bë në Prishtinë Konferenca Themeluese e Rinisë Shqiptare të Kosovës dhe të Rrafshit të Dukagjinit. Në Konferencë u trajtua situata politike, pozita e rinisë në Jugosllavinë e vjetër dhe u përcaktuan detyrat për punë në të ardhmen në theks të veçantë për zhvillimin dhe thellimin e vëllazërimit dhe të bashkimit, për mobilizimin e rinisë për ruajtjen e fryteve të LNÇ-së dhe të punojë në ngritjen kulturo-arsimore të rinisë shqiptare. Delegatët në Konferencë u zotuan se do të luftojnë kundër zakoneve që pengonin afirmimin dhe ngritjen arsimore dhe kulturore të femrës shqiptare dhe të të rinjve në përgjithësi. Konferenca përcaktoi edhe strukturën organizative të Rinisë Shqiptare të Kosovës dhe të Metohisë. Në nivel të Krahinës kishte: Konferencën dhe Këshillin Krahinor, kurse nëpër rrethe: plenumin, këshillin dhe sekretariatin. Strukturë të tillë organizative kishte edhe në qytete: Prishtinë, Pejë, Prizren dhe Mitrovicë e Titos, pastaj këshillat e vendit të Rinisë Shqiptare dhe organizatat themelore. Organizatat e BRKJ-së, BURAJ-it në rrethin e Mitrovicës së Titos u mobilizuan për formimin e organizatës së Rinisë Shqiptare në rrethin e tyre. Pas formimit të organizatave themelore nëpër fshatra dhe qytete u zgjodhën edhe këshillat e vendit të Rinisë Shqiptare, këshilli i qytetit të Rinisë Shqiptare dhe në qershor u bë Konferenca e rrethit të Rinisë Shqiptare. Në Konferencë u trajtua situata politike dhe pozita e rinisë shqiptare në Jugosllavinë e vjetër. Aty u përcaktuan detyrat për punë në të ardhmen dhe u zgjodhën 20 të rinj anëtarë të këshillit të rrethit dhe sekretariati prej 5 anëtarësh.<sup>44</sup>

Organizatat e Rinisë Shqiptare në rrethin e Mitrovicës së Titos punuan për kryerjen e të gjitha detyrave që u shtruan në Konferencë si dhe ato që shtroheshin nga organizata e BRKJ-së dhe e BURAJ-it. Anëtarët e Organizatës së Rinisë Shqiptare u anëtarësuan në mënyrë kolektive në BURAJ. Të gjitha problemet që ishin të përbashkëta trajtoheshin, koordinoheshin dhe zgjidheshin bashkërisht në organizatat e rinisë. Kurse, Organizata e Rinisë Shqiptare angazhohej edhe për zgjidhjen e atyre problemeve që ishin

---

<sup>44</sup> AK, Fondi: Fronti Popullor K-4, 1945.

të veçanta, si: lufta kundër prapambetjes, lufta për përfshirjen e të rinjve në shkolla, emancipimin e femrës shqiptare dhe hapjen e kurseve për mësimin e shkrimleximit.

Organizatat e Rinisë Shqiptare në rrethin e Mitrovicës së Titos morën pjesë aktive për rindërtimin e vendit dhe u dalluan me punë në aksionet punuese të rinisë të organizuara në nivel të rrethit, Krahinës dhe Jugosllavisë.

#### **e. Përtëritja dhe formimi i Organizatave të Sindikatave të Unjisuara të Punëtorëve dhe të Nëpunësve në rrethin e Mitrovicës së Titos**

Partia Komuniste e Jugosllavisë gjatë LNÇ-së formoi organizata politiko-shoqërore nëpërmjet të cilave ushtronte ndikimin e vet në masa. Punëtorët edhe para se të formoheshin sindikatat, në mënyrë të organizuar, morën pjesë në rindërtimin dhe në stabilizimin e vendit nëpërmjet Këshillave të Punëtorëve të FPN-së. Nga këto këshilla u formuan më vonë shoqatat sindikale. Formimi i këtyre këshillave filloi me çlirimin e viseve nga pushtuesit. Këshillat e Punëtorëve të FPN-së u formuan në fshatra, qytete, fabrika, rrethe dhe qarqe. Anëtar i këtyre këshillave mund të bëhej çdo njëri që pranonte programin e Luftës Nacionalçlirimtare. Në këtë kohë qëllimi i luftës ishte: vazhdimi i luftës deri në fitore, rindërtimi dhe ndërtimi i vendit dhe i shtetit.<sup>45</sup> Me formimin e këshillave të punëtorëve të FPN-së nëpër fabrika, ndërmarrje të mëdha, xehore dhe qytete u bë e mundshme që organet e pushtetit popullor të japin udhëzime edhe për formimin e këshillave profesionale. Pas një mobilizimi të tillë filloi puna për aftësimin e xehoreve, fabrikave, ndërmarrjeve dhe punëtorëve për prodhim. Krahas kësaj këshillat e punëtorëve luftonin edhe kundër mbeturinave të regjimit të vjetër dhe bashkëpunëtorëve të pushtuesit.<sup>46</sup> Për të kryer detyra të tilla ishte e nevojshme që prej punëtorëve të formoheshin batalionet punuese. Këto batalione, kur aftësonin ndërmarrjen e vet për prodhim, në rast nevojë, u ndihmonin të tjerëve, si në ndërmarrje, ashtu edhe në aksione: pastrimi i rrugëve, mbledhja e ndihmave për të varfërit, dhënia e gjakut, aftësimi i shtëpive për banim, ndërtimi i urave e të tjera.

Komiteti Qendror i PKJ-së dha direktivën për formimin e sindikatave nëpërmjet udhëheqjeve partiake kombëtare dhe krahinore. Prandaj, kjo zbatohet sipas mundësive në viset e caktuara të vendit. Për këtë qëllim u formua Këshilli Aksional dhe nëpër viset e ndryshme të Jugosllavisë filloi regjistrimin e anëtarëve në sindikata. Me kryerjen e kësaj detyre u krijuan kushte që të thirrret konferenca e përgjithshme për formimin e Sindikatave të Unjisuara të Punëtorëve dhe të Nëpunësve të Jugosllavisë. Deletat për Konferencë u zgjodhën nëpër njësite federale dhe Kon-

<sup>45</sup> *O organizacionim jormama rada NF Jugoslavije*, 14. XI. 1944.

<sup>46</sup> Arkivi i LS të Jugosllavisë, Fondi. KZ/ I, 45.

ferenca u mbajt në Beograd prej 23—25 janar të vitit 1945. Konferenca shqyrtoi këto çështje: Detyrat e Sindikatave të Unjisuara në këtë fazë të Luftës Nacionalçlirimtare, struktura organizative e Sindikatave të Unjisuara, Sindikatat e Unjisuara dhe çështja e politikës sociale, Puna kulturo-arsimore dhe Shkolla e Sindikatave.<sup>47</sup> Konferenca e Parë aktivitetin e sindikatave e orientoi në mobilizimin e klasës punëtore në një organizatë të njësuar, e cila do t'i drejtonte të gjitha fuqitë për rindërtimin e vendit, t'i ofronte ndihmë të gjithanshme Frontit, me qëllim që vendi të çlirohej nën parullën: „Çdo gjë për front — çdo gjë për fitore mbi fashizmin”; të organizonte dhe të zhvillonte marrëdhënie të reja ndaj punës; të organizonte gara; të zhvillonte vetiniciativën e punëtorëve në punëtori, ndërmarrje dhe në çdo vend pune; të forconte disiplinën në punë dhe të zhvillonte aktivitetet të gjithmbarshëm për rindërtimin e vendit.

Konferenca miratoi Statutin e Sindikatave të Unjisuara të Punëtorëve dhe të Nëpunësve të Jugosllavisë, me të cilin u përcaktuan parimet themelore dhe struktura organizative e Sindikatave të Unjisuara. Statuti fillonte me parimin e organizatave të sindikatave industriale: një ndërmarrje — një shoqatë sindikale dhe një degë e ekonomisë një lidhje e sindikatave.<sup>48</sup> Në këtë mënyrë u krijua baza për organizimin e organizatave SUPNJ-së. Si detyra të drejtpërdrejta të Sindikatit, Konferenca miratoi disa masa nga lëmi social: tetorëshi si ditë pune, nxjerrja e ligjit të ri për punë, pushimi vjetor i paguar për punëtorë dhe nëpunës, mbrojtja e të rinjve dhe e nxënësve në ekonomi, mbrojtja higjieno-teknike në punë, barazia e femrës me mashkullin sipas parimit për punë të njëjtë — rroga e njëjtë, centralizimi i sigurimit social nën udhëheqjen e shtetit dhe e sigurimit të të gjithë punëtorëve dhe nëpunësve.

Këshilli Ekzekutiv dhe Plenumi i Këshillit Qendror të SUPNJ-së dhanë udhëzime për regjistrimin e anëtarëve në organizatat sindikale dhe për pagimin e anëtarësisë. Këto udhëzime ishin në Statutin e përkohshëm, sipas të cilit SUPNJ ishin të përbëra nga 21 lidhje profesionale, kurse në mars të vitit 1945 u bënë 26 lidhje të tilla.<sup>49</sup> Në strukturën e përgjithshme në SUPNJ u pranua sistemi i dyfishtë i organizimit: vertikal dhe horizontal. Në bazë të parimit vertikal, zbatohet organizimi sipas degëve të ekonomisë dhe të veprimtarive të tjera shoqërore, me drejtoritë qendrore të Lidhjes, me këshillat e vendit dhe shoqatat e ndërmarrjeve. Sipas parimit horizontal, organizimi i këshillave kryesore nëpër republika e krahina, këshillat sindikale të vendit harmonizonin punën si udhëheqje kryesore me Këshillin Qendror të Sindikatave. Në punën e Konferencës së Përgjithshme të Sindikatave të Unjisuara të Punëtorëve dhe të Nëpunësve të Jugosllavisë mori pjesë edhe de-

<sup>47</sup> *Po aty.*

<sup>48</sup> AIHK, K-7c.

<sup>49</sup> AIHK, Fondi: LSJ, K-1.

legacioni i Krahinës së Kosovës i përbërë prej 11 delegatëve, të cilët kryesisht ishin delegatë të shoqatave sindikale nga Mitrovica e Titos.

Pas çlirimit të Kosovës, klasa punëtore me iniciativën e vet filloi të formonte Këshillat e Punëtorëve, të cilat kishin për qëllim aftësimin e punëtorëve dhe të objekteve të tjera prodhuese. Mirëpo, për shkak të pozitës së vështirë dhe luftërave që zhvilloheshin, ato iniciativa u ndërpreen, sepse në tërë Krahinën u vendos Administrata Ushtarake, e cila kishte për qëllim që sa më parë të zgjidheshin çështjet dhe të normalizohej gjendja, si në sferën e luftës, ashtu edhe në ato ekonomike dhe politiko-shoqërore. Megjithatë, klasa punëtore e Kosovës, bashkë me masën e gjerë popullore, në radhë të parë me fshatarësinë e varfër, përballuan dhe tejkaluan të gjitha vështirësitë. Kjo mund të shpjegohet vetëm me disponimin revolucionar që kishte përfshirë masën. Ato u ndihmuan organeve ushtarake dhe atyre të pushtetit popullor në zgjidhjen e të gjitha çështjeve.

Komiteti Krahinor PKJ i Kosovës dhe i Metohisë ndihmoi në mënyrë të gjithanshme formimin e shoqatave të Sindikatave të Unjisuara. Ndihma është dhënë nga anëtarët e Komitetit Krahinor, por ajo rezultonte edhe nga detyrat që shtroheshin para komiteteve të vendit dhe organizatave të Partisë në ato vende, ku duhej të formoheshin shoqatat dhe të organizoheshin punëtorët.

Organizata e Partisë në rrethin e Mitrovicës së Titos pas çlirimit u angazhua që të formoheshin shoqatat sindikale dhe të organizoheshin punëtorët në Platformën e Luftës Nacionalçlirimtare. Pas formimit të SUPNJ-së edhe më shumë u intensifikua puna për formimin e shoqatave sindikale në rrethin e Mitrovicës së Titos. Në konferencën e rrethit të Partisë, u bë më 8 dhe 9 mars të vitit 1945, një ndër detyrat që shtroheshin para organizatave të Partisë ishte formimi dhe zhvillimi i shoqatave sindikale. Kjo bëri që të arriheshin edhe rezultate. Kështu, në prill të vitit 1945 në rrethin e Mitrovicës së Titos ishin formuar dhe punonin 17 organizata sindikale me 1.720 anëtarë.<sup>50</sup> Përveç kësaj, ishte formuar këshilli i sindikatit të qytetit dhe u bënë përgatitjet për mbajtjen e konferencës në nivel të rrethit. Organizatat sindikale në rrethin e Mitrovicës së Titos ishin organizuar sipas parimit të organizimit horizontal dhe vertikal. Struktura e tillë e organizimit krijonte kushte për një organizim më të mirë të aktivitetit të shoqatave sindikale në rrethin e Mitrovicës së Titos. Gjendja gadi e ngjashme ishte edhe në rrethet e tjera të Krahinës së Kosovës dhe të Metohisë, ngase ishin organizuar në sindikata rreth 10.000 anëtarë dhe punonin në 130 shoqata, të cilët përfshin në gjirin e vet punëtorët e të gjitha nacionaliteteve të Kosovës.<sup>51</sup> Kjo tregon se në organizimin e punëtorëve në Sindikata të Unjisuara ishin arritur rezultate të dukshme dhe se ishin pjekur të gjitha kushtet për të thirrë Konferencën Themeluese Krahinore për formimin e Sindikatave të Unjisuara të Punëtorëve dhe të Nëpunësve të Kosovës e të Meto-

<sup>50</sup> Si shën. 13.

<sup>51</sup> Arkivi i LS të Kosovës, S-1, K-1.

hisë. Konferenca u bë në Prishtinë më 16 tetor 1945. Konferencën e shpalli të hapur Bajram Ismaili. Kërsta Filipoviqi paraqiti në Konferencën referatin mbi „Detyrat ekonomike, politike dhe organizative”, kurse Andro Qukuqi për „Pozitën ekonomike, politike, tarifore dhe mbi entet sociale”. Në mbledhje u miratua Rezoluta dhe u zgjodh Këshilli Krahinor.<sup>52</sup> Në Konferencë morën pjesë edhe delegatët e shoqatave sindikale të rrethit të Mitrovicës së Titos dhe me përvojën e vet të organizimit në sindikata ndihmuan për orientim të punës në të ardhmen.

Organizatave e Sindikatave në rrethin e Mitrovicës së Titos aktivitetin e vet e orientuan për zbatimin në jetë të detyrave që u shtruan në Konferencën Themeluese të Sindikatave të Kosovës dhe të Metohisë në të gjithë lëmenjtë. Organizatat sindikale u mobilizuan për formimin e kooperativave, të cilat kishin për qëllim të kujdeseshin për furnizimin e qytetarëve me artikuj të ndryshëm. Kooperativat kishin për qëllim edhe zhvillimin e vetëdijes kolektive dhe që në udhëheqjet e tyre të zgjedhnin punëtorët dhe në këtë mënyrë të ndikonin në zgjerimin e vetëdijes revolucionare. Shoqatat sindikale në rrethin e Mitrovicës së Titos iu përgjigjen kërkesës për organizimin e garave socialiste dhe korrën suksese. Gjatë vitit 1945 u shpallën 150 punëtorë SULMUES, prej tyre 130 ishin nga ndërmarrja e „Trepçës”. Organizata sindikale në krahinën „Trepça” gjatë vitit 1946 u angazhua për shtimin e prodhimit dhe gjatë marsit të këtij viti nxori mbi plan 3.400. Suksese edhe më të mëdha u arritën edhe në muajt e tjerë të atij viti. Kjo ishte punë vetëmohuese, por nuk mund të zhvillohej në ato kushte të punës pa sakrifica edhe në njerëz. Kështu, në mars të vitit 1946 vdiq një punëtorë dhe u plagosën rëndë dhe lehtë 25 xehetarë.<sup>53</sup> Me rastin e Një Majit shoqatat sindikale korrën suksese të mëdha. Puna me intensitet të tij vazhdoi gjatë tërë vitit. Ky ishte kontribut i madh për rindërtimin e vendit. Punëtorët e organizuar në sindikata morën pjesë aktive në të gjitha aksionet që i organizonte Fronti Popullor në rrethin e Mitrovicës së Titos. Prandaj, puna e tërësishme e tyre trajtohet edhe në kuadër të Frontit Popullor të rrethit të Mitrovicës së Titos.

*Dr. Fehmi Pushkollli*

LES ORGANISATIONS POLITICO-SOCIALES A MITROVICÉ DE TITO  
ET DANS SES ENVIRONS PENDANT LA PÉRIODE  
DE LA RECONSTRUCTION (1945—1947)

R é s u m é

Après la libération de Mitrovica de Tito et de ses environs à la fin de novembre de 1944 se créèrent les conditions pour une activité légale des organisations politiques qu'elles étaient formées et pour la formation d'autres

<sup>52</sup> *Po aty.*

<sup>53</sup> AIHK, Sig. 600, nr. 1 dok. 2472.

organisations politico-sociales conduites par le Parti communiste yougoslave. Le but de toutes les organisations politico-sociales était la stabilisation de la situation politique, la formation des organes du Pouvoir populaire, la continuation de la lutte pour la libération d'autres contrées de la Yougoslavie, la lutte contre la réaction intérieure et la reconstruction du pays démolé pendant la Deuxième guerre mondiale. C'est dans ce sens se distingue parment, et au niveau de la ville de Mitrovicë de Tito.

Le P.C.Y. par son activité ses cohérences et ses orientations pour la formation des organisations politico-sociales désigna le programme de leur activité. A Mitrovicë de Tito, l'organisation du P.C.Y. dans la période de la reconstruction, s'était bien consolidée au point de vue organisationnel augmentant bien le nombre de ses membres. Un rôle important a joué à la formation des organes du Pouvoir populaire, à l'élection des députés comme représentant du peuple dans l'Assemblée de la Province Autonome de Kosovë et de la Metochie, l'Assemblée de la République Populaire de Serbie et l'Assemblée la R.F.P. de Yougoslavie.

Dans la période de la reconstruction du pays, à Mitrovicë de Tito sont formées ont et travaillé les organisations politico-sociales suivantes; l'Organisation du P.C.Y. au niveau de l'arrondissement et de la ville, le Front commun de la Libération nationale dont après le Congrès Constitutif se nomma le Front Populaire, l'Union de la jeunesse communiste de Yougoslavie, l'Union d'Unité de la Jeunesse Antifasciste de Yougoslavie pour la Kosovë et la Metochie et la Jeunesse albanaise de la Kosovë et de la Plaine de Dukagjin.

Le Comité national des Albanais de Kosovë et de la plaine de Dukagjin et La ligue des Syndicats Unis des Travailleurs et des Employés de Yougoslavie. Toutes ces organisations politico-sociales faisaient un large front et arrivent dans la ville de Mitrovicë de Tito et ses environs à faire avec succès la reconstruction de l'arrondissement et à donner une bonne contribution à la reconstruction du pays en général.

